

PROF. DR. BESNIK ALIAJ

EDUKIMI

- **Profesor.** Universiteti Politeknik i Tiranës, Vendim i Komisionit të Titujve Akademikë, 2013
- **PhD.** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, 2007
- **MSc.** Universiteti Erasmus, Rotterdam, Master në Manaxhim Urban, 1996
- **MSc.** Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; Dega: Arkitekturë, 1990

EKSPERIENCA

- Besnik Aliaj është një nga themeluesit dhe rektor i U-POLIS, si dhe profesor titullar në fushat e planifikimit dhe dizajnit urban. Studimet universitare i ka finalizuar për arkitekturë pranë Universitetit të Tiranës, në prag të ndryshimeve të vitit 1990. Më pas kreu studimet pasuniversitare në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban pranë Universitetit Erasmus Roterdam Holandë (1995);
- Aliaj ka kryer specializime të tjera pasuniversitare në Shqipëri (U-Politeknik Tirane), Danimarkë (IPC College Helsingor), Norvegji (U-Oslo), Itali (U-Firenca), SHBA (Harvard Business School dhe IVP Program @ State Department), si dhe në Peru (ILD Lima);
- Ka mbrojtur gradën "Doktor i Shkencave" si dhe titujt akademikë "Docent" dhe "Profesor". Përtej historisë së themelimit të institucionit akademik alternativ U_POLIS, Prof. Aliaj ka një përvojë të pasur akademike dhe njohje mjaft të mirë të sistemit arsimor në Shqipëri dhe më gjerë, duke filluar nga viti 1992 deri sot. Kjo përfshin edhe 13 vjet përvojë si staf i brendshëm në Universitetin Politeknik Tiranë, dhe 10 vjet si staf i ftuar në Universitetin e Arteve Tiranë;
- Ai ka lektuar edhe në Universitetin Darmshtad Gjermani, pa folur për mjaft leksione si i ftuar kyç në disa universitete europiane dhe mjaft konferenca ndërkombëtare;
- Besnik Aliaj është ndër të tjera bashkëthemelues dhe ish drejtues i Institutit pioner profesional në fushën e planifikimit urban Co-PLAN; të studios së arkitekturës "Metro-Polis", si dhe të periodikut shkencor të vetëm në trojet shqipfolëse për arkitekturën dhe planifikimin urban "Forum A+P"; duke e zgjeruar konsiderueshëm gamën e kontributeve të tij shkencore, teorike dhe praktike në fushat e interesit;
- Ai është autor i mjaft teksteve dhe artikujve në gjuhët shqip dhe anglisht;
- Prof. Aliaj është ndërkohë një intelektual i spikatur me kontribute dhe pozicione për çështje të interesit publik, përfshi: reformat e qeverisjes vendore, të planifikimit të territorit, të formalizimit të ekonomisë, të arsimit dhe shkencës, si dhe mjaft kauzave të shoqërisë civile në vend.

